



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 tetor 2021
Nr.ref.:RK 1877/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI184/20

Parashtrues

Đeljalj Kazagić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Pzd. nr. 61/2020, të 24 shtatorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Đeljalj Kazagić (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me banim në Mitrovicë, i cili gjendet në vuajtje të dënimit me burgim.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme Pzd. nr. 61/2020, të 24 shtatorit 2020 (në tekstin e mëtejme: Aktvendimi i kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes i kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, i cili, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 1.1 [Përkufizimi i Shtetit], 3.2 [Barazia para Ligjit], 7.1 [Vlerat], 24.1 [Barazia para Ligjit], 29.4 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33.4 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe 125.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 12 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës Nr. KK-SP 71-2/21, u konfirmua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

9. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e Kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilët ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, përfshirë edhe rastin aktual.
10. Më 26 qershor 2021, në bazë të paragrafit (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës Nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori funksionin e Kryetares së Gjykatës, ndërsa në bazë të pikës 1.1, paragrafi 1, të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi e përfundoi mandatin e Kryetares dhe gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin Nr. K.SH.KI184/20, me të cilin e zëvendësoi Kryetaren e mëparshme, Arta Rama-Hajrizi, si anëtare të Kolegjit shqyrtues me gjyqtarin Nexhmi Rexhepi.
12. Më 7 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesë në Gjykatë për herë të gjashtë.

Faktet në lidhje me kërkesën e parë KI82/16

14. Më 24 maj 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesën KI82/16, përmes së cilës kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 13/2016 të 13 nëntorit 2016, me të cilin pretendonte se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës.
15. Më 1 mars 2017, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri me të cilin e deklaroi kërkesën e parashtruesit qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, sepse i njëjti nuk i mbështeti pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.

Faktet në lidhje me kërkesën e dytë, KI50/18

16. Më 30 mars 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI50/2018, përmes së cilës e kontestonte kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme Pml.nr. 110/2017, të 13 nëntorit 2017, duke pretenduar se gjykatat e rregullta, me refuzimin e kërkesës së tij për rishikimin e procedurës penale, shkelën nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], paragrafi 3, të Kushtetutës, *“sepse atij i ishte mohuar e drejta për t’iu siguruar mbrojtje dhe mundësia që të kontestonte deklaratat e dëshmitarit dhe provat të cilat e ngarkonin atë”*, si dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafët 1 dhe

2 të Kushtetutës me pretendimin “se atij i ishte pamundësuar pjesëmarrja në seancën e Gjykatës së Apelit”.

17. Më 16 janar 2019, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri pasi që konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e kërkesës së tij për rishikimin e procedurës penale nga ana e gjykatave të rregullta, si të tilla, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, meqenëse neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës nuk aplikohet në rastet e tilla.

Faktet në lidhje me kërkesën e tretë KI186/18

18. Më 30 mars 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI186/2018, përmes së cilës kontestonte kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme Pml.nr 168/2018, të 3 gushtit 2018, duke pretenduar se gjykatat e rregullta, me refuzimin e kërkesës së tij për rishikimin e procedurës penale, shkelën nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse atij i ishte pamundësuar të ishte i pranishëm në seancën e Gjykatës së Apelit.
19. Më 8 maj 2019, Gjykata pasi që vlerësoi rrethanat e rastit, nxori Aktvendimin për papranueshmëri dhe konkludoi se neni 6 i Konventës nuk aplikohet për procedurat për rishikimin e një rasti të veçantë penal. Për këtë arsye, Gjykata konsideroi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e kërkesës së tij për rishikimin e procedurës penale nga ana e gjykatave të rregullta, si të tilla, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës, ishte e papranueshme.

Faktet në lidhje me kërkesën e katërt KI96/19

20. Më 12 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI96/19, përmes së cilës kontestonte kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pzd.nr. 8/2019, të 5 shkurtit 2019, duke pretenduar se Gjykata Supreme, me refuzimin e kërkesës së tij për rishikimin e procedurës penale, kreu shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, për shkak se nuk mori parasysh faktet dhe rrethanat lehtësuese në lidhje me zbutjen e dënimit.
21. Më 8 tetor 2019, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri dhe arriti në përfundimin se neni 6 i Konventës nuk aplikohet për procedurat për rishikimin e një rasti të veçantë penal. Për këtë arsye, Gjykata konsideroi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e kërkesës së tij për rishikimin e procedurës penale nga ana e gjykatave të rregullta, si të tilla, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës, ishte e papranueshme.

Faktet në lidhje me kërkesën e pestë KI35/20

22. Më 5 qershor 2019, parashtuesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë një kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P. nr. 42/2014, të 12 shkurtit 2015, i cili ishte konfirmuar nga ana e Gjykatës së Apelit me Aktgjykimin PAKR. nr. 230/15, të 7 shtatorit 2015 dhe i cili u ndryshua vetëm sa i përket pjesës që lidhet me dënimin, duke i shqiptuar kësisoj parashtuesit të kërkesës një dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vitesh.
23. Më 22 korrik 2020, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri dhe arriti në përfundimin se pretendimet e parashtuesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e kërkesës së tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nga ana e gjykatave të rregullta, si të tilla:
- Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;
 - Sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve 21.4, 24.1, 33.4, 54 dhe 55.5 të Kushtetutës, sipas bazave kushtetuese, gjithashtu duhej të deklaroheshin të papranueshme si qartazi të pabazuara, në përputhje me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa e parashtuesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, ishte e papranueshme.

Faktet në lidhje me kërkesën aktuale KI184/20

24. Më 13 gusht 2019, parashtuesi i kërkesës dorëzoi një kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P. nr. 42/2014, të 12 shkurtit 2015, cili ishte konfirmuar nga ana e Gjykatës së Apelit me Aktgjykimin PAKR.nr. 230/15, të 7 shtatorit 2015 dhe i cili u ndryshua vetëm sa i përket pjesës që lidhet me dënimin, duke i shqiptuar kësisoj parashtuesit të kërkesës një dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vitesh.
25. Më 3 shtator 2020, Gjykata Themelore në Mitrovicë, kërkesën e parashtuesit të kërkesës, ia përcolli Gjykatës Supreme për vendosje, me propozimin që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet. Gjithashtu, më 11 shtator 2020, Prokurori i Shtetit i propozoi Gjykatës Supreme të refuzojë kërkesën e parashtuesit.
26. Më 24 shtator 2020, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Pzd.nr. 61/2020, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, me arsyetimin se: *"... Me dispozitën e nenit 429 të KPPK-së, parashikohet se zbutja e dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë lejohet kur paraqiten rrethana që nuk kanë ekzistuar në kohën kur është marrë aktgjykimi ose gjykata nuk ka ditur për to, megjithëse kanë ekzistuar, e të cilat qartazi do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të butë.*

(...)Pretendimet e të dënuarit të shprehura në kërkesë, nuk mund të kenë ndikim në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Kjo për faktin se rrethana që e ka paraqitur i dënuari në kërkesën e tij nuk është rrethanë që do të ndikon në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, nga se vepra penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçe është inkorporuar në kapitullin XX të Kodit të ri penal. Në anën tjetër nuk ka ndikim në statusin e tij ndryshimi eventual i ligjit, pasi që i dënuari paraprakisht është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë dhe kjo nuk paraqet bazë ligjore për ushtrimin e këtij mjeti juridik. Andaj, rrethana në të cilën thirret i dënuari në kërkesë është përceptim apo interpretime të gabueshëm të të dënuarit dhe rrethanat nuk janë të asaj natyre që do të ndikonin në zbutjen e dënimit e as që mund të karakterizohen si rrethana që e arsyetojnë shqiptimin e dënimit më të butë. Andaj, rrethanat të cilat ceken në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e kanë karakterin e rrethanave nga dispozita e nenit 429 të KPPK-së, të cilat do të ishin bazë për aprovimin e kërkesës”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Supreme, me Aktvendimin e kontestuar, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 1, 3, 7, 24, 29, 32, 33, 54, 102 dhe 125 të Kushtetutës, si dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës.
28. Parashtruesi i kërkesës ankohet në mënyrë të përgjithësuar se arsyetimi i Aktvendimit të kontestuar është në kundërshtim të plotë me ligjet e aplikueshme në Kosovë në rastin e tij, sepse Gjykata Supreme nuk e ka zbatuar ligjin më të favorshëm me rastin e vendosjes në rastin e tij, duke deklaruar, “vepra e keqpërdorimit seksual të personave nën moshën 16 vjeçe, posaqërisht nën rrethana të ndërprerjes së procedurës penale për akuzën-veprën – e dhunimit, [...] dhe shpallja fajtor për veprën penale tentim të mundësimin të prostitucionit nga neni 201 i KPPK-së fare nuk mund të inkorporohet në Kapitullin XX të Kodit të Ri (nr. 06/L – 074) [...] Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pzd.nr. 61/2020 i datës 24.09.2020, me arsyetimin e kundërligjshëm i konteston plotësisht të gjitha dispozitat ligjore të neneve të lartcekura dhe shkakton shkelje të rëndë - shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të deklaruara në fillim (nenet 1, ... 125) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe shumica e të cilëve janë të garantuar me Konventën Evropiane si dhe protokollin e saj për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.
29. Tutje, ai pretendon se moszbatimi i disa dispozitave ligjore të KPPK-së dhe KPRK-së, siç është neni 3 [Zbatimi i ligjit më të favorshëm] nga ana e Gjykatës Supreme, ka shkaktuar shkeljen të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:
 - “1. Të anulon Aktvendimin Pzd.nr. 61/2020 të datës 24.09.2020 të Gjykatës Supreme e cila refuzon kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të ushtruar më 13.08.2019 dhe çështjen(kërkesën) t’ia kthen Gjykatës

Supreme të Republikës së Kosovës në rishëyrtrim-vendosje ligjore, ose në pëlqim të kompetencave të Gjykatës Kushtetuese;

2. *Të ndryshon Aktgjykimin PAKR. nr. 230/2015 të Gjykatës së Apelit të datës 07.9.2015 me të cilin më dënon plotfuqishëm për katër(4) vepra penale(të cekura më herët) me burgim prej dymbëdhjetë (12 = 4 + 2 + 2 + 4) vjet dhe me dënim unik prej njëmbëdhjetë (11) vjet burgim, ashtu që për veprën penale:Keqpërdorim Seksual i Personave nën moshën 16 Vjeç (në kundërshtim me nenin:198.1 të KPK-së), për të cilën jam dënuar me katër (4) vjet burgim (plotfuqishëm), sipas kësaj kërkesë dhe kërkesës për zbutje të jashëzakonshme të dënimit, të anulon këtë dënim (me pëlqim të nenit 3.3 të KPRK-së Nr. 06/L-074 dhe nenit 33.4 të Kushtetutës)- të zbutë shumën e dënimit nga dymbëdhjetë (12) në tetë (8)=(8 = 0 + 2 + 2 + 4) vjet burgim, më saktësisht të cakton dënimin e plotë prej shtatë vjet e gjysmë(7,5) eventualisht shtatë (7) vjet e njëmbëdhjetë (11) muaj dënim të plotë me burgim.”*

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç kërkohet me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve të pranueshmërisë, siç janë theksuar më lartë, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili e konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme Pzd. nr. 61/2021 të 24 shtatorit 2020, pasi që i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka theksuar të drejtat dhe liritë për të cilat ai pretendon se i janë shkelur, në përputhje me kushtet e nenit 48 të Ligjit si dhe e ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
35. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur edhe kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, përkatësisht në paragrafët (2) dhe (3) (b) të rregullit 39 të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...]

36. Gjykata së pari sqaron se nuk do të merret me vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës të cilat janë shqyrtuar nga ana e Gjykatës në rastet KI82/16, KI50/18, KI186/18, KI96/19 dhe KI35/20. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme Pzd. nr. 61/2020, të 24 shtatorit 2020, me të cilin, sipas pretendimeve, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 1, 3, 7, 24, 29, 32, 33, 54, 102 dhe 125 të Kushtetutës, si dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës.
37. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhet me mënyrën e arsyetimit të Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i cili pretendohet se është dhënë nga e njëjta në kundërshtim të plotë me ligjet e

aplikueshme në Kosovë në rastin e tij, pasi që Gjykata Supreme nuk e ka zbatuar ligjin më të favorshëm me rastin e vendosjes në rastin e tij.

38. Gjykata gjithashtu vëren se parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij nuk e përmend në mënyrë eksplicite nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës, por është e qartë nga pretendimet e tij se thelbi i kërkesës së tij ka të bëjë me arsyetimin e gabuar, përkatësisht me zbatimin e gabuar të ligjit në arsyetimin e dhënë nga ana e Gjykatës Supreme, e që rezulton me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, një e drejtë që garantohet nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës.
39. Në lidhje me këtë, në vijim, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtuesit të kërkesës në lidhje me: i. shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës për shkak të zbatimit të gabuar ligjit; dhe ii. shkeljet e pretenduara të neneve 1, 3, 7, 24, 29, 32, 33, 54, 102 dhe 125 të Kushtetutës si dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës, duke zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), në harmoni me të cilën Gjykata, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
- i. *Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës*
40. Gjykata rikujton, para së gjithash, se e drejta e kërkuar nga parashtuesit e kërkesës duhet të jetë e mbrojtur dhe e garantuar me Kushtetutë e gjithashtu edhe me Konventë. Prandaj, në rrethanat e këtij rasti konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse e drejta e kërkuar nga parashtuesi i kërkesës mbrohet me Kushtetutë dhe Konventë, përkatësisht nëse neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës janë të zbatueshëm në rastin e tij.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Supreme një *“kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit”* përmes Gjykatës Themelore, në pajtim me KPPRK-në. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata vëren se Gjykata Supreme vlerësoi vetëm aspektet procedurale të pranueshmërisë së kërkesës së parashtuesit, dhe nuk preku thelbin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P. nr. 42/2014, të 12 shkurtit 2015, i cili u bë i plotfuqishëm me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 220/2015 të 7 shtatorit 2015.
42. Në këtë drejtim, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, rikujton se neni 6 i Konventës nuk është i zbatueshëm në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti penal, nëse një person dënim i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe ai ose ajo gjatë kësaj procedure nuk është *“akuzuar për ndonjë vepër penale”* brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës (shih, rastet e GjEDNj-se *Franz Fischer kundër Austrisë*, kërkesa nr. 27569/02, vendimi i 6 majit 2003).

43. Në rastin konkret, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, e ushtruar në Gjykatën Supreme, në fakt ka kërkuar rihapjen e procedurave të perfunduara me vendim të plotfuqishëm, sa i përket vendimit për dënimin. Megjithatë, siç mund të verohet nga arsyetimi i Gjykatës Supreme, ajo e refuzoi si të pabazuar kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit për shkak se konkludoi se e njëjta nuk i përmbushte kushtet ligjore për rihapjen e Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr. 42/2014, të 12 shkurtit 2015, sa i përket vendimit për shqiptimin e dënimit.
44. Në këtë vazhde, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, e cila parasheh: *"...neni 6 i Konventës, nuk gjen zbatim, përderisa autoritet vendore nuk pranojnë të rihapin një procedure, madje edhe në ato raste ku parashtruesi kishte paraqitur kërkesën për rihapje të procedurës në sajë të një aktgjykimi të meparshëm të Gjykatës me të cilin është vërtetuar se ka pasur shkelje të Konventës në lidhje me procedurën e kontestuar para gjykatave vendore (shih Aktgjykimin e GjEDNj-së Franz Fischer kundër Austrisë, kërkesa nr. 37950/97, e 29 majit 2001). Megjithatë, në atë moment kur procedura rihapet ose kur aprovohet rishikimi i jashtëzakonshëm i procedurës, mekanizmat mbrojtës nga neni 6 i Konventës zbatohen për tërë procedurën gjyqësore (shih Vendimin e GjEDNj-së Vanyan kundër Rusisë, kërkesa 53203/99, e 15 dhjetorit 2005, paragrafët 56-58)*
45. Për më tepër, Gjykata rikujton se mjetet juridike të jashtëzakonshme me të cilat kërkohet zbutje e jashtëzakonshme e dënimit zakonisht nuk implikojnë vërtetimin e *"të drejtave dhe obligimeve civile"* apo bazueshmërinë e *"çfarëdo akuze penale"*, dhe rrjedhimisht neni 6 nuk zbatohet për ta (shih, ndër të tjera, *X kundër Austrisë*, numër 7761/77, Vendimi i Komisionit i 8 majit 1978, *Hyrter kundër Zvicrës*, Vendimi numër 48111/07 i 15 majit 2012, *Dybeku kundër Shqipërisë*, Vendimi numër 557/12, paragrafi 30, i 11 marsit 2014).
46. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme [Pzd. nr. 61/2020], të 24 shtatorit 2020, ka ardhur deri tek shkelja e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, e në lidhje me nenin 6 të Konventës nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
 - ii. *Sa i përket pretendimeve të tjera në lidhje me shkeljet e neneve 1, 3, 7, 24, 29, 32, 33, 54, 102 dhe 125 të Kushtetutës, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës*
47. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 1, 3, 7, 24, 29, 32, 33, 54, 102 dhe 125 të Kushtetutës si dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tej se si dhe pse ka ardhur deri tek shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Shkeljet e të këtyre neneve parashtruesi i kërkesës në thelb i ndërlidh me zbatimin e pretenduar të gabuar të ligjit, përkatësisht me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës, ndërsa këto pretendime të

parashtruesit të kërkesës tashmë janë vlerësuar nga Gjykata se nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën (shih rastin e Gjykatës KI135/20, parashtruese: *Hava Behxheti*, Aktvendim për papranueshmëri i 31 dhjetorit 2020, paragrafi 54).

48. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi në nenet e Kushtetutës dhe të Konventës nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të ofrojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastin e Gjykatës KI175/20, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 81; shih rastin e Gjykatës KI166/20, të cituar më lartë, paragrafi 51). Andaj, në lidhje me këto pretendime, Gjykata, në përputhje me praktikën e saj, kërkesën e parashtruesit të kërkesës e deklaroi qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme.
49. Prandaj, Gjykata vie në përfundimin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e neneve 1, 3, 7, 24, 29, 32, 33, 54, 102 dhe 125 të Kushtetutës, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar dhe mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij në lidhje me shkeljet e të drejtave të tij, por thjesht vetëm ka përmendur një ose më shumë dispozita të Konventës ose Kushtetutës, pa e shpjeguar me atë rast mënyrën se si janë shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

50. Në bazë të asaj që është thënë më sipër, Gjykata vjen në përfundimin se kërkesa e parashtruesit:
- i. në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;
 - ii. në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 1, 3, 7, 24, 29, 32, 33, 54, 102 dhe 125 të Kushtetutës si dhe nenit 1 të Protokollit nr.12, sipas bazave kushtetuese gjithashtu duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) dhe (3) (b), si dhe rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani